

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

1. — Faruk Besho, *Një analizë matematike e formimit të fjalëve shqipe prej rrokjeve*, në «Buletin i USHT, Seria shkencat natyrore» 1969, nr. 1, ff. 51-63.

A ka ndonjë rregullsi në përdorimin e fjalëve njerrokëshe, dyrrokëshe etj. në gjuhën shqipe, cila është denduria e përdorimit të tyre dhe si paraqitet nga kjo pikëpamje gjuha shqipe në krahasim me gjuhë të tjera? Këtyre pyetjeve është përpjekur t'u japë një përgjigje sa më të kënaqshme autori i artikullit që po recensojmë. Ai ka analizuar për këtë katër fragmente nga vepra të katër autorëve shqiptarë: nga «Historia e Skënderbeut» e F. S. Nolit një fragment me gjatësi 28.490 fjalë, nga «Tregimet e moçme shqiptare» të M. Kutelit një fragment me gjatësi 32.135 fjalë, nga «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë një fragment me gjatësi 29.137 fjalë dhe nga «Lumi i vdekur» i J. Xoxës një fragment me gjatësi 20.265 fjalë, pra një tekst me gjatësi të përgjithshme prej 110.027 fjalësh. Autori ka quajtur fjalë çdo bashkësi shkronjash që ndodhen ndërmjet dy intervaleve dhe numrin e rrokjeve e ka marrë të barabartë me numrin e zanoreve. Kështu që nyjet e përparme *i, e, të, së* të mbiemrave si edhe pjesëza *të* e lidhore, pjesëza *do*, pjesëza *u* si proklitike etj. janë numëruar si fjalë të veçanta, nga ana tjetër trajtat e shkurtëra dhe pjesëza *u* në pozicion enklitik janë numëruar si një fjalë bashkë me foljen së cilës i ngjiten, d.m.th. *jepi, çohu* janë numëruar si fjalë dyrrokëshe. Në këtë mënyrë fjala është kuptuar jo si njësi leksikore, po si njësi fonetiko-drejtshkrimore. Përfundimet e llogaritjeve të F. Beshos po i paraqesim në pasqyrën e mëposhtme:

Numri i rrokjeve	Denduria absolute				Denduria relative			
	Noli	Kadareja	Xoxa	Kuteli	Noli	Kadareja	Xoxa	Ku'eli
1	12289	13339	9715	15722	0,4313	0,4578	0,4794	0,4892
2	9273	10209	7825	12646	0,3255	0,3504	0,3861	0,3935
3	4229	3789	2022	3025	0,1484	0,1300	0,0998	0,0941
4	2324	1407	628	705	0,0816	0,0483	0,0310	0,0220
5	333	335	68	31	0,0117	0,0115	0,0034	0,0010
6	40	54	7	5	0,0014	0,0019	0,0003	0,0002
7	2	4	—	1	0,0001	0,0001	—	—
Shuma	28490	29137	20265	32135	1,0000	1,0000	1,0000	1,0000

Denduri absolute është quajtur numri që shënon sa herë del një fjalë 1, 2, 3... rrokëshe në numrin e përgjithshëm të fjalëve që janë marrë nga secili autor. Sikur për çdo autor të ishte marrë një numër i barabartë fjalësh, p.sh. 30.000, atëherë edhe nga krahasimi i dendurive absolute do të delte qartë veçantia e secilit prej tyre. Por këtë gjë mund ta shohim te pasqyra e dendurisë relative, e cila është raporti midis dendurisë absolute dhe numrit të përgjithshëm të fjalëve, p.sh. për Nolin 12289

$$28490 = 0,4313$$

(denduria relative e fjalëve njërrrokëshe te Noli). Kjo do të thotë se te Noli fjalët njërrrokëshe zënë 43,13% të tekstit, dyrrrokëshet 32,55%, trirrrokëshet 14,84%, katërrrokëshet 8,16%; pesërrrokëshet 1,17%, gjashtërrrokëshet 0,14%, shtatërrrokëshet 0,01%; po kështu edhe për autorët e tjerë. Gjatësia mesatare e fjalës është: për Nolin 1,9215, për Kadarenë 1,8114, për Xoxën 1,6941, për Kutelin 1,6527. Nga të gjitha këto shihet se Kuteli me Xoxën janë shumë afër njëri me tjetrin, kurse Noli me Kadarenë dhe Kadareja me Xoxën ndryshojnë më shumë. Si duhet shpjeguar kjo? F. Beshua këto dallime i shpjegon si veçori të stilit të tyre. Ai mendon se denduria e përdorimit të fjalëve sipas numrit të rrokjeve «mund të shërbejë si një veçori për të krahasuar stilin e autorëve të ndryshëm». Për ilustrim të kësaj ideje autori ka dhënë paraqitjen grafike të dendurisë relative të përdorimit të fjalëve 1, 2, 3... rrokëshe te dy poetë anglezë Shekspiri (1564-1616) dhe Haksli (Aldous Huxley 1894-1963) dhe te dy shkrimtarë romakë Cezari (101-44 para e.r.) dhe Salusti (86-35 para e.r.), marrë nga artikulli i V. Fuksit «Teoria matematike e fjalëformimit»¹. Sido që të jetë puna me këta autorë të huaj (për rastin e Shekspirit dhe të Hakslit nuk mund të mos merret parasysh edhe periudha prej më se tre shekujsh që i ndan), për autorët tanë na duket se ndryshimi midis tyre nuk ka të bëjë aq me stilin si mënyrë vetjake të shkuari, sesa me stilin si një nënsistem i veçantë i gjuhës, me fjalor, frazeologji, konstrukte etj. karakteristike, që përcaktohen nga sfera e përdorimit të tyre. Kështu, libri i Kutelit, si libër përrallash, që i drejtohet një lexuesi pak të zhvilluar nga ana intelektuale, përmban kryesisht fjalë të zakonshme, nga më të përdorshmet, shumica të shkurtëra; romani i Xoxës flet për jetën e përditshme të masave fshatare të Myzeqesë në të kaluarën dhe leksiku i tij përbëhet kryesisht prej fjalësh të gjuhës popullore, shumica gjithashtu të shkurtëra (një deri trirrrokëshe); romani i Kadaresë trajton një temë të Luftës nacionalçlirimtare dhe të ditëve tona; leksiku politiko-shoqëror, në përbërjen e të cilit hyjnë një numër i madh fjalësh tre e më shumë rrokëshe, përdoret dendur në të, po ashtu edhe në «Historinë e Skënderbeut» të Nolit, që është një vepër historike-letrare². Nga ana tjetër në këto dy veprat e fundit janë të rralla ose nuk përdoren fare një tog fjalësh njërrrokëshe (përemra, pjesëza, pasthirma), karakteristike për stilin dialogjik. Veç kësaj mjafton të kemi parasysh edhe se sa dendur i është dashur Nolit të përdorë emrat *Skënderbeu* e *Venetia* dhe Kadaresë emrin *Gjenerali*, që të kuptojmë atë ndryshim të madh të dendurisë relative të fjalëve katërrrokëshe që na tregon pasqyra. Por diapazoni i ndryshimeve ndërmjet të katër autorëve në fjalë nuk është shumë i madh. Gjatësia mesatare e fjalës lëviz nga 1,9215 rrokje për Nolin deri në 1,6527 për Paskon, pra ndryshimi është 0,2688 rrokje. Kjo tregon se tipi i gjuhës vë disa kufi të prerë, relativisht të ngushtë, brenda të cilëve realizohen të gjitha dallimet stilistike të gjatësisë mesatare të fjalëve në rrokje.

Në bazë të të dhënave të tabelës së mësipërme F. Beshua ka llogaritur se për

1) W. Fuks, *Mathematical Theory of Word-Formation* në «Information Theory — Paper read at a Symposium on «Information Theory» held at the Royal Institution, London, September 12th to 16th 1955; (është shfrytëzuar botimi rusisht *Teoriya peredaci soobshçenij*, M. 1957).

2) Ndryshimin e përbërjes së fjalëve sipas numrit të rrokjeve në vartësi nga stili e ka vënë në dukje N. S. Trubeckoj te kapitulli mbi statistikën fonologjike në librin e tij *Bazat e fonologjisë*. Ai ka marrë në mënyrë krejt të rastit një fragment prej 200 fjalësh nga vepra e K. Bühlerit «Sprachtheorie» (Jena 1934) dhe një fragment po prej kaq fjalësh nga një libër përrallash. Te fragmenti nga Bühleri kanë dalë 95 fjalë njërrrokëshe, 57 dyrrrokëshe, 27 trirrrokëshe, 7 katërrrokëshe, 6 pesërrrokëshe, 6 gjashtërrrokëshe, 1 shtatërrrokëshe e 1 nëntërrrokëshe, kurse te fragmenti nga libri i përrallave kanë dalë 134 njërrrokëshe, 56 dyrrrokëshe dhe 10 trirrrokëshe. Këtë ndryshim kaq të theksuar ai e shpjegon me të drejtë me ndryshimin e madh ndërmjet stileve të këtyre veprave, «që përfaqësojnë dy poet, ndërmjet të cilave shtrihen stilet e tjerë» (N. S. Trubeckoj, *Osnovy fonologii*, Moskva, 1960 f. 287vv).

tekstet shqipe mesatarisht 46,41% e fjalëve janë njërrrokëshe, 36,31% dyrrrokëshe, 11,87% trirrrokëshe, 4,60% katërrrokëshe, 0,7% pesërrrokëshe, 0,10% gjashtërrrokëshe dhe 0,01% shtatërrrokëshe. Gjatësia mesatare e një fjale shqipe është 1,7721 rrokje, dhe, duke qenë se numri i rrokjeve është i barabartë me numrin e zanoreve, kjo shifër shënon edhe sasinë mesatare të zanoreve për një fjalë. Po të vendosen këto të dhëna të shqipes në tabelën e hartuar nga Fuksi për nëntë gjuhë, del se shqipja qëndron midis gjermanishtes dhe esperantos. Në këtë tabelë sipas dendurisë relative të fjalëve një - deri nëntërrrokëshe dhe sipas gjatësisë mesatare të fjalës (po mjaftohemi duke dhënë vetëm dendurinë relative të fjalëve njërrrokëshe d_1 dhe gjatësinë mesatare) janë renditur këto gjuhë:

	angli-shtja	gjermani-shtja	shqipja	esperan-tura	arabi-shja	greqi-shtja	japo-ni-htja	rusi-shtja	latini-shtja	turqi-shtja
d_1	0,7152	0,5560	0,4641	0,4040	0,2270	0,3760	0,3620	0,3390	0,2420	0,1880
gj. mes	1,351	1,634	1,772	1,859	2,104	2,105	2,137	2,228	2,392	2,455

Ndryshimi që ka shqipja nga anglishtja e gjermanishtja shpjegohet jo vetëm me numrin më të madh të fjalëve njërrrokëshe që duhet të kenë këto gjuhë në krahasim me shqipen, por edhe me dy rrethana të tjera. Në ato dy gjuhë nyjet shquese janë prepozitive dhe shkruhen veç nga emri, duke u llogaritur natyrisht si fjalë të veçanta, kështu që ndërsa *the book* ose *das Buch* numërohen secila si dy fjalë njërrrokëshe, shqip *libri* numërohet si një fjalë dyrrrokëshe. Po të mbajmë parasysh numrin e madh të emrave në çdo lloj teksti, pesha e kësaj rrethane kuptohet vetiu. Rrethana tjetër është se anglishtja e gjermanishtja e vënë rregullisht përemrin vector (dhe këta janë të gjithë njërrrokësh) para foljes, kurse shqipja nuk e gjen të nevojshme këtë mënyrë, për shkak se i ka ruajtur pak a shumë mirë mbaresat vector. Në këtë tabelë është për të vënë re se gjuhët analitike e analitiko-sintetike e kanë gjatësinë mesatare të fjalës mjaft të vogël dhe përqindjen e fjalëve njërrrokëshe mjaft të lartë, kurse gjuhët sintetike (rusishtja, latinishtja) dhe aglutinativet (turqishtja), përkundrazi gjatësinë mesatare të fjalës e kanë të madhe dhe përqindjen e fjalëve njërrrokëshe mjaft të ulët. Kjo vjen nga që fjalët shërbyese, që përbëjnë mjetin më tipik për shprehjen e kuptimeve gramatikore të gjuhët analitike, janë përgjithësisht fjalë njërrrokëshe, e shumta dyrrrokëshe. Mungesa ose përdorimi i kufizuar i këtyre fjalëve shërbyese në gjuhët sintetike ndikon mjaft që pesha specifike e fjalëve njërrrokëshe në të mbetet e vogël. Nga vendi që zë shqipja në tabelën e mësipërme mund të nxirret një përfundim edhe për shkallën e analizimit të saj dhe për dendurinë e përdorimit të mjeteve analitike.

Artikulli që shqyrtuam, megjithëse tani për tani nuk ka ndonjë vlerë praktike të drejtpërdrejtë, është me interes, sepse zbulon një anë të panjohur të strukturës së shqipes dhe hap rrugën për studime të tjera statistikore, të cilat, në fazën e parë, është e kuptueshme se do të kufizohen kryesisht në vënjen në dukje të fakteve. Për sa i takon mundësisë së studimit të stilit të autorëve të veçantë me këtë metodë, do të ishte një punë shumë e vlefshme sikur të shqyrtoheshin fjalitë e periudhat nga pikëpamja e numrit të gjymtyrëve ose të fjalive që i përbëjnë si edhe llojet e tipet e këtyre fjalive e periudhave. Në këtë mes duhet pasur parasysh që veprat e analizuarat të jenë të një gjinie, pasi metodikisht nuk mund të përligjet krahasimi i stilit të dy autorëve që shkruajnë vepra në gjini të ndryshme.

2. — Faruk Besho, *Mbi mundësinë e rritjes së shpejtësisë së transmetimit të njoftimeve në telegrafi, duke marrë parasysh probabilitetin e përdorimit të shkronjave dhe fonemave të ndryshme në gjuhën shqipe*, në «Buletin i USHT, Seria shkencat natyrore» 1969, nr. 2, ff. 113-120.

Fonemat e një gjuhe kanë denduri të ndryshme dhe çdo gjuhë ka veçoritë e saj nga kjo pikëpamje. Caktimi i dendurisë së fonemave dhe të shkronjave që përdoren për t'i shënuar ato ka shumë rëndësi në telegrafi për caktimin e një kodi të tillë, ku fonemat që përdoren më dendur të shënoheshin me sinjalet më të shkurtëra dhe të rritej kështu gjatësia e tekstit të transmetuar në një kohë të dhënë. Duke dashur të hetojë mundësinë e përmirësimit të kodit telegrafik ekzistues, autori ka caktuar edhe probabilitetin e përdorimit të fonemave e të shkronjave të thjeshta në gjuhën shqipe. Ai thotë se për këtë ka shqyrtuar «tekste të shkruar nga autorë të ndryshëm, si në gjuhën e sotme letrare ashtu edhe në dialektin e Veriut» me një gjatësi të përgjithshme prej 126.644 fonemash, por mjerisht nuk ka shënuar se cilët janë autorët e teksteve dhe në ç'përpjestim janë teksteve e shkruara «në dialektin e Veriut» ndaj atyre të shkruara në gjuhën letrare. Kjo rrethanë bën që përfundimet e arritura të kenë një vlerë relative, pasi nuk pasqyrojnë qind për qind gjendjen e gjuhës letrare.

Një punë të ngjashme ka ndër marrë para tre vjetësh, si temë vjetore, studenti Islam Alla. Ai ka shqyrtuar: 1) 1199 fonema nga E. Hoxha, «Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i pushtetit» (f. 35); 2) 1037 fonema nga N. Prifti, «Çezma e floririt» (f. 169-170); 3) 989 fonema nga N. Prifti, «Një pushkë më shumë» (f. 3-4); 4) 1000 fonema nga M. Kuteli, «Xinxifilua» (f. 102-103); 5) 1095 fonema nga Sh. Musaraj, «Para agimit» vëll. I f. 3-4, gjithësej 5320 fonema. Megjithëse kjo sasi është rreth 24 herë më e vogël se ajo që ka shqyrtuar F. Beshua dhe si rrjedhim shkalla e saktësisë është më e ulët, prapëseprapë për shkak të karakterit homogjen të gjuhës së autorëve, është me interes që përfundimet e këtyre punimeve të paraqiten në mënyrë të krahasuar:

A	B	A	B	A	B	A	B
1) ë	e	10) m	o	19) dh	v	28) nj	gj
2) e	ë	11) p	k	20) l	q	29) y	rr
3) t	t	12) k	q	21) ll	dh	30) rr	ll
4) i	i	13) s	s	22) q	h	31) c	th
5) a	a	14) sh	sh	23) gj	g	32) ç	c
6) r	r	15) j	j	24) z	f	33) th	ç
7) n	n	16) d	d	25) f	z	34) x	zh
8) u	m	17) b	l	26) g	y	35) xh	x
9) o	u	18) v	b	27) h	nj	36) zh	xh

A (=Alla) B (=Besho)

Nga pasqyra vihet re se vetëm për fonemat *t, i, a, r, n, s, sh, j, e d* pra për një të katërtën e sasisë, llogaritjet e Beshos dhe të Allës pajtohen. Mospajtimi për fonemat *ë dhe e* që zënë dy vendet e para besoj se shpjegohet me këto rrethana, që F. Beshua ka shqyrtuar edhe tekste gegërisht, ku natyrisht mungojnë shumë *ë* (një pjesë që nuk shqiptohen e që nuk shkruhen, një pjesë, së cilës në gegërishten i përgjigjet *a*-ja hundore, një pjesë, së cilës i përgjigjet *e*-ja hundore), kurse I. Alla ka shqyrtuar autorë që e përdorin *ë*-në edhe për ato raste, kur drejtshkrimi rekomandon *e*-në (para bashkëtingëlloreve hundore si *vënd, zëmër* etj.). Për mospërputhjen e rradhës së fonemave të tjera besojmë se ndikon sasia e ndryshme e fonemave të numë-

ruara nga njëri dhe tjetri dhe koeficienti i rastësisë. Por duhet vënë në dukje se fonemat me dendurinë më të lartë përputhen në radhën e tyre. Kështu fonemat *e*, *ë*, *t*, *i*, *a*, *r*, *n*, përbëjnë 57,47% të gjithë tekstit të analizuar nga F. Beshua dhe 57,40% të I. Alla. Kjo do të thotë se denduria e këtyre fonemave i nënshtrohet një rregullësie më të madhe dhe se këto të shtata bartin më shumë se gjysmën e informacionit të çdo teksti, gati 60%. Denduria relative e fonemave të shqipes, ose përqindja që zë çdo fonemë në një tekst shqip, sipas llogaritjes së F. Beshos është kjo:

1) e	10,49	10) o	3,65	19) v	1,28	28) gj	0,65
2) ë	10,45	11) k	3,22	20) q	1,19	29) rr	0,50
3) t	8,43	12) p	3,05	21) dh	1,01	30) ll	0,47
4) i	8,11	13) s	2,96	22) h	0,86	31) th	0,47
5) a	7,51	14) sh	2,53	23) g	0,82	32) c	0,33
6) r	6,28	15) j	2,45	24) f	0,81	33) ç	0,31
7) n	6,20	16) d	2,38	25) z	0,79	34) zh	0,06
8) m	4,29	17) l	1,76	26) y	0,71	35) x	0,05
9) u	3,93	18) b	1,30	27) nj	0,67	36) xh	0,06

Nga kjo tabelë shihet se zanoret, me përjashtim të *y*-së janë të vendosura në vendet nga i pari te i dhjeti dhe kanë një denduri të lartë. Duke llogaritur përqindjen e përdorimit të fonemave sipas tipit të tyre akustik shohim se zanoret përbëjnë 44,85% të tekstit, pas tyre vijnë bashkëtingëlloret e shurdhëta me 24,16%, sonoret me 22,62% dhe më në fund bashkëtingëlloret e zëshme me 8,38%. Por të gjitha këto shifra kanë një vlerë relative, sepse ato pasqyrojnë fonemat e shkruara, e jo fonemat e shqiptuara, për të cilat interesohet fonologjia. Kështu fonema *ë* që në shkrim zë 10,45% nuk dimë se sa për qind do të zinte po të numëroheshin fonemat e shqiptuara të një teksti të lidhur. Po ashtu, për shkak të mosshqiptimit të *e*-së te togjet *ue*, *ye* edhe përqindja e përdorimit të *e*-së do të pësonte një ulje. Fonemat me dendurinë më të ulët në gjuhën shqipe janë bashkëtingëlloret afrikate *c*, *ç*, *x*, *xh*.

Ky klasifikim i fonemave sipas dendurisë vërteton edhe nga ana e shqipes pohimin e Marsel Koenit se «prej dy gjymtyrëve të një opozicioni privativ gjymtyra e pamarkuar në të folurit e lidhur haset më dendur sesa e markuara» dhe vërejtjen e Trubeckoit se pohimi i mësipërm «nuk duhet marrë si një rregull që nuk lejon asnjë përjashtim» 1. Dhe me të vërtetë, po të shikojmë çiftet bashkëtingëllore e zëshme — bashkëtingëllore e pazëshme, që përbëjnë opozicione privative, del se nga të dhjetë çiftet e tilla që ka shqipja, vetëm te dy prej tyre, *v-f* e *dh-th* gjymtyra e pamarkuar ka një denduri më të lartë se e pamarkuara. Po të marrim parasysh edhe se një pjesë e fonemave që janë llogaritur si të zëshme, vetëm shkruhen kështu, po shqiptohen si të shurdhëta, atëherë raporti midis dendurisë së përdorimit të të zëshmeve dhe të të shurdhëtave, që kështu është 1:29 do të ndryshojë në të mirë të të shurdhëtave.

Pas llogaritjes së dendurisë së fonemave F. Beshua ka bërë edhe llogaritjen e dendurisë së të 27 shkronjave që përdoren në shkrimin e shqipes. Radha e shkronjave bashkë me pjesën (në përqindje) që zë secila në një tekst të dhënë është kjo:

1) e	9.86 ⁰ / ₀	8) s	5.16 ⁰ / ₀	15) k	3.03 ⁰ / ₀	22) z	0.80 ⁰ / ₀
2) ë	9.82 ⁰ / ₀	9) h	4.66 ⁰ / ₀	16) p	2.87 ⁰ / ₀	23) f	0.76 ⁰ / ₀
3) t	8.37 ⁰ / ₀	10) m	4.03 ⁰ / ₀	17) l	2.55 ⁰ / ₀	24) y	0.67 ⁰ / ₀
4) i	7.62 ⁰ / ₀	11) u	3.69 ⁰ / ₀	18) g	1.38 ⁰ / ₀	25) c	0.31 ⁰ / ₀
5) a	7.06 ⁰ / ₀	12) j	3.53 ⁰ / ₀	19) b	1.23 ⁰ / ₀	26) ç	0.29 ⁰ / ₀
6) r	6.84 ⁰ / ₀	13) o	3.43 ⁰ / ₀	20) v	1.20 ⁰ / ₀	27) x	0.08 ⁰ / ₀
7) n	6.45 ⁰ / ₀	14) d	3.19 ⁰ / ₀	21) q	1.12 ⁰ / ₀		

Duke u nisur nga kjo renditje e shkronjave autori ka propozuar një kod të ri ekonomik, i cili siguron një fitim prej 7.5%, d.m.th. në një sasi kohe të dhënë me këtë kod transmetohet 7.5% tekst më shumë. Në kodin e ri janë ndryshuar kombinimet koduese të 15 shkronjave, ndërsa 12 shkronja kanë mbetur të pandryshueshme. Por autori ka gjetur edhe një mënyrë tjetër më ekonomike. Ai propozon që të kodohen fonemat, d.m.th. fonemat e shkruara (*dh, gj, nj* etj., të mos transmetohen si (*d+h, g+j* etj., po sikur të ishin një shkronjë. Me kodin e ndërtuar nga autori mbi këtë bazë arrihet, sipas llogarisë së tij, një fitim prej 12.30%.

Këto përfundime besojmë se janë të vlefshme për t'u pasur parasysh nga specialistët e ndërlidhjes e të shtypshkronjave. Ato mund të gjejnë zbatim edhe për gjetjen e një vendosjeje më të përshtatshme të shkronjave në makinat daktilografike, në mënyrë që të rritet shpejtësia e shkrimit. Edhe për gjuhëtarin, veçanërisht për foneticienin nuk është pa interes caktimi i dendurisë së fonemave. Mund të ndërmerrej edhe një krahasim midis dialekteve ose fazave të ndryshme të zhvillimit të gjuhës nga kjo pikëpamje.

E. LAFE